



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **20.2.2024**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje nënkryetar **Fatmir Iska**! Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm! Faleminderit shumë për pjesëmarrjen! E hapim mbledhjen e dytë (2) të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.325/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim;
3. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;
4. Shqyrtimi i vendimit për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve në Komunën e Rahovecit;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi: A kemi ndonjë pikë apo propozim shtesë nga anëtarët e KPF-së? Nëse jo, atëherë e kemi një pikë shtesë, shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për të filluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, deri në 25 vjet, personave fizikë dhe juridikë. E kalojmë në votim rendin e ditës si të tillë. Kush është “për” këtë rend dite?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me shumicë votash aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A kemi ndonjë diskutim, vërejtje apo koment rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash votohet pika e parë.

2. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.325/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim:

Skender Hamza: Përshëndetje për të gjithë! Te ky komitet na duhet një emër i ri, pasi zonja Ellma Hamza nuk është më pjesë e kuvendit dhe pjesë e këtij komiteti, prandaj për mbledhje të KPF-së, Ellma Hamza duhet të zëvendësohet me një emër tjetër.

Kryesuesi: Faleminderit, Skender Hamza! Atëherë nëse nuk ka dikush ndonjë gjë shtesë, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht kalon edhe pika e dytë.

3. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024:

Nënkryetari: Përshëndetje për të gjithë! Vendimin 01 Nr.174/23, të datës 27 dhjetor 2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024, duhet ta shfuqizojmë, sepse kështu e kërkojnë nga ministria e linjës.

Arsyeja e shfuqizimit është që duhet të ndërrohet kodi buxhetor, prej mallrave dhe shërbimeve që është aktualisht, duhet të vendoset në subvencione dhe të vazhdohet me procedura të tjera.

Kryesuesi: Faleminderit, nënkryetar! Atëherë nëse nuk ka dikush ndonjë gjë shtesë, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht kalon edhe pika e tretë.

4. Shqyrtimi i vendimit për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve në Komunën e Rahovecit:

Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Me këtë vendim bëhet plotësimi i listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve në Komunën e Rahovecit. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe ajo e Shërbimeve Publike.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Atëherë, nëse nuk ka dikush ndonjë gjë shtesë, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht kalon edhe pika e katërt. Vazhdojmë me pikën shtesë.

5. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për të filluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, deri në 25 vjet, personave fizikë dhe juridikë:

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, sipas ligjeve të aplikueshme të Republikës Kosovës, kemi vendimin që mundëson procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës, deri në 25 vjet. Bëhet fjalë për P-02302-0 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur *Ravne Shume*, me kulturë kullosë e klasës 5, në sipërfaqe të përgjithshme 199774m². Parcela e dytë P-02299-0 në zonën kadastrale në Rahovec, në vendin e quajtur *Grot*, me sipërfaqe të përgjithshme prej 6806m². Qëllimi ka të bëjë me ushtrimin e veprimtarisë biznesore, respektivisht vendosjen e paneleve solare.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Atëherë nëse nuk ka dikush ndonjë gjë shtesë, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht kalon edhe pika që ishte si pikë shtesë.

6. Të ndryshme:

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! E shoh të arsyeshme të propozoj që pika e dytë, që është në mbledhjen e rregullt të Kuvendit, pyetje dhe përgjigje në pyetjet e kuvendarëve, t'i shtohet edhe një fjalë tjetër (... dhe diskutime), për arsye që t'i evitojmë mosmarrëveshjet dhe ta respektojmë rregulloren e Kuvendit.

Skender Hamza: Përshëndetje edhe një herë! Unë kam përvojë mbi 12 vjet në Sekretari të Kuvendit dhe pika për të cilën fole ka qenë “të ndryshme”, por me iniciativën e kuvendarëve është shndërruar në “pyetje dhe përgjigje në pyetjet e kuvendarëve”. Sidoqoftë, mund edhe të modifikohet përsëri.

Kryesuesi: Faleminderit, Skender Hamza! Atëherë, nëse nuk ka dikush ndonjë gjë shtesë, ju njoftoj që për mbledhje të Kuvendit do të jenë edhe këto pika në rend dite:

Informatë e DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024;

Informatë mbi kontratat publike të Komunës së Rahovecit;

Raport nga Zyra e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 dhe diskutimi i planit të veprimit;

Raport mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA-ja, për vitin 2022;

Mbledhja përfundoi: 10:30

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

